



Datë: 24.09.2025
Numër Protokolli: 6360/2025

A.nr.1462/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1462/2025, të datës, 25.07.2025, të parashtruar nga ankueses M.D.K, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1462/2025, e datës 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesja M.D.K.

II. Anulohet Njoftimi i datës 02.07.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin me numër Reference: RN00017734, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* në fazën e testimit me shkrim.

III. Obligohet Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të tij, duke ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimi në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim të procedura të zhvillohet nga faza e vlerësimit të testit me shkrim.

IV. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja M.D.K (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 25.07.2025 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net, me numër protokolli 5071/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00017734, për pozitën “Zyrtar për Arkiv 2”, të shpallur nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit më datë 04.08.2025 në OSHP, ndërsa Këshilli më datë 20.08.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kryetari i Këshillit, me datë 04.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 5953/2025, përmes të cilit ankuesës së ankueses nën shenjë A.nr.1462/2025 të datës 25.07.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshill me numër protokolli:5071/2025 e datës 23.07.2025; Vendimin e Këshillit me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 5953/2025; Konkursin e datës 29.04.2025; Njoftimin e datës 13.06.2025 për fazën e verifikimit paraprak; Njoftimin e datës 02.07.2025 për Rezultatet Përfundimtare; Vërtetimin e datës 09.11.2018; Vërtetimin e datës 06.01.2016; Vërtetimin e datës 08.02.2016; Shkresë e datës 18.02.2015; Kopjen e ID së ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.08.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 20.08.2025; Listën e aplikantëve; Formularët e vlerësimeve të eses nga anëtarët e Komisionit të Pranimit; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në procedurë të datës 02.07.2025; Listën përfundimtare të vlerësimit; Formularin e renditjes përfundimtare të datës 02.07.2025; Vendimin e datës 16.06.2025 për themelimin e Komisionit të pranimit me akt emërimet e anëtareve të komisionit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e shpallur; Testet me shkrim të kandidatëve; Aplikacionin e kandidates N.G i datës 30.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 52 faqes; Aplikacionin e ankueses i datës 01.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 19 faqes; Aplikacionin e kandidates A.A i datës 30.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 52 faqe; Kërkesë e datës 16.09.2025; Përgjigje e datës 16.09.2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1214/2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1215/2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1219/2025; Akt Emërimin e datës 07.08.2024 me shifër Nr.04/2024; Akt Emërimin e datës 31.07.2024 me shifër Nr.03/2024;

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është **e bazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Organi Shqyrtues i Prokurimit , më datë 29.04.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër Reference RN00017734, gjegjësisht për pozitën e punës, “Zyrtar për Arkiv 2”, me afat për aplikimi nga data 30.04.2025 deri më datë 29.05.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 112 kandidatë, të cilët kriteret i kanë plotësuar 62 kandidatë ndërsa 50 prej tyre nuk e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, në mesin e kandidatëve që e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak është edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim të kësaj procedure rekrutimi, mirëpo ka arritur të marr vetëm 48.8 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullore Nr. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *‘2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.’*, ndërsa sipas listës përfundimtare të kandidatëve kandidatja A.B është, renditur e para në këtë listë me gjithsejtë 94.8, pikë të arritura, kandidatja e dytë B.A ka arritur gjithsejtë 72.4 pikë nga kjo procedurë rekrutimi, ashtu që sipas Njoftimit të datës 02.07.2025 sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve, të Divizioni të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, rezulton se kandidate fituese është kandidatja A.A e cila ka marr më shumë pikë, gjithsejtë 94.8, prej të cilave 67.4 në testin me shkrim, ndërsa 27.4 në intervistën me gojë.

Ankuesja, e pa kënaqur me rezultatet përfundimtare për kandidatët e suksesshëm, në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedura e rekrutimit është përcjellë më parregullsi dhe mungesë të objektivitet ashtu dhe me mundësi të manipulimit të procesit të testimit, me kërkesën që të rishqyrtohet procesi i vlerësimit, përbërja e komisionit dhe mënyra e vlerësimit.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, , lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017734 për pozitën e kategorisë Grupi i arkiv – dokumentacionit , profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomën arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor në drejtimet: Juridik/ Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë/Antropologji,Balistikë;* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku në vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga rrjedh se kërkesat e përgjithshme formale të cekura si më lartë janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcës Nr.1/3 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për Profesional 2 si dhe katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil.*

Kolegji i Këshillit pas konstatimit të gjendjes faktike të pasqyruar si në arsyetimin e këtij vendimi, me rastin e vendimmarrjes mori përbazë Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenit 20 paragrafi 2, ku është përcaktuar se: *“2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.”*, ndërsa përmes Vendimit Nr.827/25 të datës 16.06.2025 të UD Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së është themeluar Komisioni i Pranimit prej 5 anëtarësh në këtë përbërje: V. B-Kryetar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.1214/2025 të datës 29.08.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Përgjithshme”; S. B-anëtar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.1219/2025 të datës 29.08.2025 mban pozitën

“Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave”; A. B-anëtare, e cila sipas Akt të Emërimit Nr.1219/2025 të datës 01.09.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore”; S. S-anëtare, e cila sipas Akt të Emërimit Nr.04/2024 mban pozitën “Zyrtare e lartë për të Hyra”, si dhe A. M-anëtar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.03/2024 të datës 31.07.2024 mban pozitën “Zyrtar i lartë për pranimin e ankesave dhe protokollit”, nga rrjedh se Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe paragrafin 2, neni 20 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pasi që përveç tre anëtarëve të Komisionit të Pranimit, të cilët janë pozita të mesme drejtuese, në mesin e dy anëtarëve të tjerë nuk ka nga radhët e Njesisë së Burimeve Njerëzore sikurse përcaktohet me nenin 20 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 i Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ndërsa Kolegji i Këshillit e konstatoi se në mesin e tre anëtarëve nga radhët e kategorisë së ulët drejtuese është edhe Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore, mirëpo e njëjta nuk mund të plotësojë dy parakushte ligjore që ndërlidhen me themelimin e komisionit të pranimit, gjegjësisht e njëjta nuk mundet që në të njëjtën kohë të mbulojë apo plotësojë edhe parakushtin ligjor sipas nenit 20 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe parakushtin ligjor sipas nenit 20 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe për rrjedhojë përbërja e komisionit bie ndesh me pastaj edhe me nenin 20 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3 të së njëjtës rregullore, pasi që në përbërjen e komisionit të pranimit figurojnë dy anëtarë të kategorisë profesionale, e ku as njëri prej të cilëve nuk bënë pjesë apo nuk është nga radhët e njesisë së burimeve njerëzore të OSHP-së.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, dhe nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse komisioni i pranimit nuk ka qenë i themeluar sipas kriterëve ligjore, atëherë edhe procedura e vlerësimit të kandidatëve në fazën e vlerësimit profesional duke përfshirë testin me shkrim dhe intervistën me gojë, është e pavlefshme, andaj si rezultat i kësaj Njoftimi i datës 02.07.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të OSHP-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare, është i pavlefshëm dhe si i tillë nuk mund të prodhojë pasoja juridike, andaj duke marr parasysh këtë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në pretendimet tjera të ankueses, e për rrjedhojë duke marr parasysh dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi obligohet Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, të ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit të Pranimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi me qëllim që procedura e fazës së vlerësimit profesional të përsëritet, gjegjësisht të përsëriten testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankueses është aprovuar vetëm mbi konstatimin e dhënë se Komisioni i Pranimit nuk është themeluar sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara me ligjin material për shërbimin civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.1462/2025, datë 24/09/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.D.K;
- Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Organin Shqyrtues të Prokurimit si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së